



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR PËR SHKOLLAT E
MESME TË GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË SPANJOLLE

KODI: 3.6.11.Zgj.(av)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË SPANJOLLE
PËR KLASËN E 11-të
NIVELI I AVANCUAR**

Koordinatori: Erifili Hashorva

Redaktori: Gazmend Krasniqi

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, KORRIK 2010

Programi i gjuhës spanjolle për klasën 11-të ka si qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies dhe nxënies dhe vlerësimit të nxënësve duke u thelluar në nivelin gjuhësor B1+ sipas tabelës së vlerësimit të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët. Ky program i gjuhës spanjolle synon zhvillimin gjuhësor, intelektual dhe kulturor të nxënësit në mënyrë që ai të jetë i aftë të përballojë të nxënës, gjatë gjithë jetës.

Integrimi i vendit tonë në gjirin e familjes evropiane e në strukturat euroatlantike, përgatitja e qytetarit të Evropës së bashkuar, ndërveprimi dhe integrimi ekonomik, kulturor dhe arsimor, kërkon domosdoshmërisht një njohje dhe zotërim të efektshëm të gjuhëve të huaja.

Për këtë arsye përgatitet një program që i përgjigjet një niveli më të avancuar e thelluar, duke i shtuar 2 orë javore (me një numër të përgjithshëm prej 72 orësh vjetore).

Kështu, programi kërkon që nxënës/i,-ja të rrisë e të thellojë aftësitë e tij/saj formuese dhe shprehëse në gjuhën spanjolle, duke e bërë atë përdorues të pavarur.

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 11-të drejton nxënës/in,-en:

- të mësojë në mënyrë të pavarur, duke i dhënë atij/asaj besim në vetvete në realizimin e detyrave në klasë e jashtë saj;
- të zhvillojë të menduarit kritik, duke i dhënë mundësi të konsultohet me më shumë burime informacioni dhe të bëjë përzgjedhje e duhur personale;
- e përgatit nxënës/in/en për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Mësimdhënia/nxënia realizohen me sukses dhe duke ndërthurur forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj në grup.

1. SYNIMI I LËNDËS

Në përfundimin e klasës 11-të, programi i avancuar i spanjishtes synon:

- njohje më të detajuar të nxënësve me kulturën dhe qytetërimin e vendit, gjuhën e të cilit mëson, gjë që do të nxiste dëshirën e vazhdueshme të tyre për t'u thelluar në dijet e njohuritë e marra;
- një komunikim sa më të mirë të nxënësit përmes respektimit të aftësive bazë të të kuptuarit e të shprehurit me gojë, të kuptuarit e të shprehurit me shkrim;
- një përvetësim sa më të plotë të gjuhës, mbështetur në respektimin e nivelit gjuhësor të nxënësve, moshës dhe standardeve të arritjes.

Rezultatet praktike të mësimin të gjuhëve të huaja lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe shkëmbimet kulturore, shkencore dhe teknike ndërmjet tyre. Mësimi është gjithnjë e më i individualizuar dhe kontribuon në krijimin e individualiteteve. Duke mësuar spanjishten nxënës/i,-ja njih realitete të tjera, i kupton ato më mirë dhe komunikon me folës të tjerë të kësaj gjuhe. Kjo e bën atë më të hapur, zgjeron vizionin, nxit sjellje vlerësimi e respekti ndaj të tjerëve dhe së fundmi ngre në një shkallë më të lartë ndërgjegjen e qytetarisë evropiane dhe universale.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHËSH

Programi i gjuhës spanjolle për klasën e 11-të ka si objektiv të përgjithshëm të zhvillojë aftësinë analitike dhe sintetike të një informacioni më të gjerë gjuhësor dhe kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënës/i,-ja zhvillon më tej:

- shkathtësinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të lidhur situata gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallime ndërmjet kulturave të ndryshme.

Pa harruar që niveli i tyre është B1+ i mjaftueshëm për të realizuar një komunikim normal në situata të ndryshme përmes dialogimit, diskutimeve në situata familjare, shoqërore, zyrtare, formale e informale.

3. OBJEKTIVAT

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë japin bazat e gjuhës si domosdoshmëri në komunikim. Objektivi kryesor në mësimin e gjuhëve të huaja është zhvillimi i aftësive komunikuese ose kapaciteti i komunikimit gjuhësor në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme komunikimi si me shkrim dhe me gojë.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në fund të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• të tregojë ndodhi të kaluara (në kohën e shkuar);• të japë opinione dhe të vlerësojë;• të flasë për filma dhe telenovela;• të tregojë për zakonet dhe kulturat e vendeve të ndryshme;• të manovrojë me shifrat;• të transmetojë fjalët e një personi tjetër;• të justifikojë mos pranimin e një kërkesë ose të një favoriti;• të prezantojë veten e tij dhe persona të tjerë;• të përshkruajë situata të ndryshme.

	Objektiva
Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të flasë për të ardhmen; • të urojë për ditëlindje, festa te ndryshme etj.; • të bëjë propozime; • të shprehë ndjenjat (frikë, turp); • të shprehë dëshirë, keqardhje; • të japë dhe të kërkojë instruksione; • të miratojë, të kundërshtojë; • të falë dhe të kërkojë falje në situata të jetës së përditshme si: festa, ditëlindje, në treg, takime, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursione etj.

b) Objektivat sipas standardit në kulturë

Përshkrimi. Mësimdhënia/nxënia e gjuhëve të huaja ka si objekt zhvillimin e pavarësisë dhe individualitetit intelektual, shoqëror dhe kulturor të nxënësi. Rezultatet praktike të mësimin të gjuhëve të huaja lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe shkëmbimet kulturore, shkencore dhe teknike ndërmjet tyre. Mësimi nxit krijimtarinë dhe mënyrën alternative të menduarit, është gjithnjë e më i individualizuar dhe kontribuon në krijimin e individualiteteve.

	Objektiva
Kultura	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njohë kulturën dhe traditën e vendit; • të njohë festat dhe zakonet; • të përdorë sipas regjistrave të gjuhës rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit mëson (përdorim i avancuar i urimeve, përshëndetjeve etj.); • të njohë disa nga personazhet më të shquara spanjolle të historisë, kulturës dhe artit; • të njohë monumentet e artit e kulturës; • të njohë gastronominë spanjolle; • të ketë njohuri për vendet ku flitet gjuha spanjolle; • të mund të flasë për tregun, çmimet, profesionin etj.; • të njohë disa nga qytetet më të rëndësishme të Spanjës; • të dijë të shprehë një kërkesë.

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor:

Përshkrim. Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të përdorë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B1+. Nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës spanjolle, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre, në situata të ndryshme të ligjërimit.

Nxënës/i,-ja në klasën 11-të aftësohet të njohë në qoftë se fjalia ose grupi i fjalive është i rregullt nga ana gramatikore, i pranueshëm nga ana kulturore, gjuhësore dhe i përshtatshëm në kontekstin konkret, real.

	Objektiva
Elementet gramatikore	<p>Në fund të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë:</p> <ul style="list-style-type: none">• foljet e rregullta dhe të parregullta;• kohën e ardhme;• kohën e pakryer, te kryerën e thjeshtë, të kryerën;• ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë;• mënyrën lidhore;• mënyrën kushtore;• mënyrën urdhërore;• pozicionimin e përemrave në mënyrën urdhërore;• ndajfoljet dhe lokucionet ndajfoljore të frekuencës;• fjalitë e nënrenditura lidhore;• shenjat e pikësimit;• fjalitë kohore me folje në dëftore dhe lidhore;• shkurtime më të përgjithshme;

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Objektivat sipas aftësive gjuhësore janë parashikuar të sigurojnë një zotërim të gjuhës spanjolle në nivelin B1+ sipas KPE-së. Ky nivel është inkurajues për nxënës/in,-en që kërkon të ndër marrë kërkime në fushat e tjera të studimit në të cilat gjuha spanjolle mund t'i shërbejë mjaft mirë në vjeljen e informacionit nëpërmjet kësaj gjuhe.

Të dëgjuarit

- të marrë pjesë në një ligjëratë të shqiptuar qartë;
- të kuptojë shprehje dhe idioma të ndryshme;
- të kuptojë udhëzime dhe pyetje të ndryshme;

- të diskutojë mbi tema të fushave të ndryshme;
- të përshkruajë thelbin e një numri emisionesh në radio ose TV.

Të lexuarit

- të kuptojë tekste të ndryshme mbi aspekte të jetës së përditshme;
- të përshkruajë ngjarje të ndryshme të jetës në mënyrë të kënaqshme;
- të identifikojë fjalë të panjohura me ndihmën e fjalëve të tjera të tekstit;
- të analizojë tekste që përmbajnë një gjuhë të përditshme lidhur me punën, shkollën dhe kohën e lirë.

Të shkruarit

- të përcjellë informacion për tema konkrete;
- të shkruajë tekste koherente për tema të njohura;
- të shkruajë mbi veten dhe personazhe imagjinare;
- të përshkruajë kushtet e jetesës dhe profesione të ndryshme;
- të sjellë informacion për tema abstrakte dhe konkrete e ti paraqesë ato me saktësi.

5. KËRKESA TË GJUHËS SPANJOLLE NDAJ LËNDËVE TE TJERA

Programi i gjuhës spanjolle në klasën 11-të e sheh mjaft të rëndësishëm integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin e nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore.

Shohim lidhjen e spanjishtes me matematikën e shprehur në mësimin e shifrave dhe të numrave, veprimet me këmbimin e parasë ose blerjet në treg.

Shohim lidhjen e spanjishtes me shkencat sociale nëpërmjet temave si: njohja, familja, festat, profesioni, punësimi, papunësia etj.

Shohim lidhjen e spanjishtes me shkencat natyrore, p.sh me biologjinë nëpërmjet trajtimeve të temave që kanë të bëjnë me ushqyerjen, recetat e gatimit, përgatitjen e menysë etj.

Shohim lidhjen e spanjishtes me artin, reflektohet ngushtë në temat për sportin, muzikën, modën, pikturën, etj.

Trajtimi ndërlëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe të nënlinjave të tij, kryesisht për:

Edukimin intelektual: Përmes kombinimit të njohurive të ndryshme nxënësi zbulon, heton, analizon, sintetizon, përzgjedh dhe vlerëson, duke rritur cilësinë e nxënies.

Edukimin mjedisor: Ngrohja globale, riciklimi, ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimin kulturor dhe etik: Përmes lëndëve historie dhe gjeografi, sociologji nxënësit fitojnë njohuri për popullsinë spanjisht-folëse. Këto njohuri ndërthuren me dijet për kulturën e këtyre vendeve, për zakonet e doket e tyre, për mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe shprehjet etike të këtyre popujve.

Nxënësi mëson të ndërveprojnë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, që trajtohen përmes funksioneve gjuhësore, si: të kërkojnë falje e sqarime, të pyesin etj.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i klasës të 11-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës spanjolle me thellimin e nivelit B1+. Përdoruesit e tij duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës spanjolle.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash të mësimdhënies duke ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, me prirjen për t'iu përshtatur sa më afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen nëpërmjet teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare, gjithashtu:

- duke rekomanduar që nxënësi të vendoset në qendër të procesit mësimor;
- duke rekomanduar që qendra e punës është motivimi i tij, aftësimi i tij për të qenë aktiv, nevoja e tij për të mësuar, vlerësimi i sjelljes së tij;
- duke u fokusuar tek aktiviteti, veprimi, të bërit, duke e konsideruar nxënësin që mëson gjuhën si anëtar të shoqërisë që ka detyra, te cilat ai i bën me kuptim, reale, nxitëse, që stimulojnë të mësuarin me logjikë dhe përdorin gjuhën;
- duke rekomanduar që nxënësi të përdorë dhe të studiojë materiale autentike, përfshirë materiale të masmedias së shkruar e të folur, si dhe të hyjë në kontakt me folës që e kanë gjuhë amtare gjuhën që ai mëson;
- duke mësuar me kuptim, në mënyrë logjike e të ndërgjegjshme;
- çelës për çdo mësues është që të nxisë të mësuarit e mësimin me logjikë e nxënësit;
- nxënësi duhet të ketë strategjitë vetjake të të mësuarit që i japin rendiment;
- duke rekomanduar që nxënësi të mbajë parasysh identitetin e tij kulturor dhe ta krahasojë atë me kulturën e vendeve që flasin gjuhën që ai mëson;
- duke propozuar metoda të reja për vlerësimin e nxënësit, përfshirë edhe vetëvlerësimin në të gjitha nivelet e sistemit.

A. Objektivat

Objektivat e parashtruara në programin e gjuhës spanjolle për klasën e 11^{të} janë të detyrueshme për t'u realizuar nga mësuesi dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë cka përshkruhet tek objektivat. Objektivat janë të detyruara të zbatohen sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqenëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, atëherë mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënësit e tij/saj. Kjo kërkon që përvec përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, të përcaktojë objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

B. Orët mësimore

Në këtë program rreth 70% e orëve mësimore janë për thellimin e njohurive të reja lëndore, kurse 30% janë për përpunimin e njohurive.

Shpërndarja e orëve mësimore në programin e thelluar të gjuhës spanjolle

Shpërndarja e orëve mësimore në programin e thelluar të spanjishtes të klasës së 11-të është e njëjtë me atë të klasës së 10-të.

Sipas këtij programi të avancuar për nxënësit e klasës së 11-të, gjuha spanjolle do të zhvillohet me 2 orë mësimore në javë (**36 x 2 = 72 orë vjetore**) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si më poshtë:

Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre, duke mos u bazuar në renditjen e tabelës së orëve.

Komunikim dhe formim kulturor: sugjerohen 45 orë mësimore (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 32 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re dhe 30% e tyre që përbëjnë 13 orë do të jenë për përforcimin e njohurive të marra dhe për thellimin e tyre.

Formimi gjuhësor: sugjerohen 20 orë mësimore (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 14 orë, do të jenë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre që përbëjnë 6 orë do të shërbejnë për përpunimin dhe forcimin e tyre. 7 orë janë të lira.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e.

Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë. Mësuesi përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijeve është i bazuar në orën e mësimit. Kështu ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm.

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: vallëzon, eksperimenton, prodhon një maket etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësimi formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësimi diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

Vlerësimi i planifikuar, mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

Vlerësimi motivues, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës spanjolle. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

Vlerësimi përfundimtar, që është vlerësim me notë e që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe të nënlinjave për këtë grup-moshë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe rreth mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të **vlerësojë me notë**, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, mësuesi përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, deri tek ato një orëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurikulare etj.